



---

**RREGULLORE NR. 2002/13**

**MBI THEMELIMN E DHOMËS SË VEÇANTË TË GJYKATËS SUPREME TË  
KOSOVËS PËR ÇËSHTJET QË LIDHEN ME AGJENCINË E MIRËBESIMIT TË  
KOSOVËS**

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në pajtim me autorizimin që i është dhënë me Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara 1244 (1999) të datës 10 qershor 1999,

Duke marrë parasysh Regulloren e ndryshuar nr. 1999/1 të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) të datës 25 korik 1999 mbi Autoritetin e Misionit të Administratës së Përkohshme në Kosovë dhe nenin 8.1(u) të Rregullores nr. 2001/9 mbi Kornizën Kushtetuese të Vetëqeverisjes në Kosovë,

Me qëllim të krijimit të një dhome të veçantë pranë Gjykatës Supreme në Kosovë për të marrë vendime gjyqësore lidhur me kërkesat që kanë të bëjnë me vendimet apo veprimet e Agjencisë së Mirëbesimit të Kosovës konform Rregullores së UNMIK-ut nr. 2002/12 të datës 13 qershor 2002 për Themelimin e Agjencisë së Mirëbesimit dhe çështje të tjera që mund të referohen me ligj,

Me anë të kësaj shpall sa vijon:

Neni 1

Themelimi i Dhomës së veçantë

1.1 Me anë të kësaj themelohet një Dhomë e veçantë e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me Agjencinë e Mirëbesimit të Kosovës (më tej “Dhoma e veçantë”).

1.2 Selia e Dhomës së veçantë do të jetë në Prishtinë, përveç rasteve kur Dhoma e veçantë vendos të mblidhet diku tjetër për të shqyrtuar një rast të caktuar.

Neni 2

Përkufizimet

Sipas kësaj Rregulloreje:

- (a) “Agjenci” do të thotë Agjencia e Mirëbesimit të Kosovës;
- (b) “Ligj në fuqi” do të thotë ligji i aplikueshëm në Kosovë në përputhje me Rregulloren e ndryshuar të UNMIK-ut nr. 1999/24 të datës 2 dhjetor 1999;
- (c) Fjala “Korporatë” do ta ketë kuptimin sië është përcaktuar në Rregulloren nr. 2001/12;
- (d) Fjala “Ndërmarrje” do ta ketë kuptimin siç është përcaktuar në Rregulloren nr. 20012 dhe
- (e) “Rregullore nr. 2002/12” do të thotë Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2002/12 e datës 13 qershor 2002 mbi Themelimin e Agjencisë së Mirëbesimit të Kosovës.

Fjalët e çdo gjinie të përdorura në këtë Rregullore përfshijnë të gjitha gjinitë dhe numri njëjës nëkuptohet se përfshin edhe shumësin dhe se shumësi gjithashtu përfshin edhe njëjës.

### Neni 3 Përbërja

- 3.1 Dhoma e veçantë do të përbëhet nga një koleg prej pesë gjykatësve prej të cilët tre do të jenë gjykatës ndërkombëtarë, ndërsa dy gjykatës do të jenë banorë të Kosovës. Caktimin i gjykatësve për të shërbyer në Dhomën e veçantë do ta bëjë Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm pas konsultimit me kryetarin e Gjykatës Supreme.
- 3.2 Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm e cakton njërin prej gjykatësve ndërkombëtarë për kryesues të Dhomës së veçantë.
- 3.3 Me rastin e caktimit në detyrë të gjykatësve që janë banorë të Kosovës, siç është paraparë në nenin 3.1, kujdes i veçantë do t’i kushtohet përdorimit të gjuhëve të komuniteteve.
- 3.4 Nëse një gjykatës shkarkohet nga detyra, Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm pas konsultimit me kryetarin e Gjykatës Supreme do të caktojë një zëvendësgjykatës.

### Neni 4 Juridiksioni

4.1 Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm e ka juridiksionin kryesor për kërkesat apo pretendimet (angl. Claim) dhe kundërkërkesat që lidhën me:

- (a) Kundërshtimet ndaj vendimeve ose veprimeve të tjera të Agjencisë të marra në përputhje me Rregulloren nr. 2002/12, duke përfshirë ngarkimin e gjobave siç është përcaktuar në nenin 27 të Rregullores nr. 2002/12;
- (b) Kërkesat kundër Agjencisë për humbjet financiare që rezultojnë nga vendimet apo veprimet e marra në përputhje me rolin e tij si drejtues i një ndërmarrjeje apo korporate;

(c) Kërkesat, duke përfshirë kërkesat e kreditorëve ose kërkesat për pronësi, të bëra kundër një ndërmarrjeje apo korporate, që aktualisht është ose ka qenë më parë nën autoritetin administrativ të Agjencisë, ku kërkesat e tilla kanë lindur gjatë ose para se ndërmarrja apo korporata e tillë t'i jetë nënshtruar autoritetit administrativ të Agjencisë;

(d) Kërkesat që përfshijnë njohjen e një të drejte, një titulli apo interesi pronësor që është në posedim apo nën kontrollin e një ndërmarrjeje a korporate që aktualisht është ose ka qenë më parë nën autoritetin e Agjencisë kur kërkesat e tilla kanë lindur gjatë kohës ose para kohës kur ndërmarrja apo korporata e tillë i është nënshtruar autoritetit administrativ të Agjencisë;

(e) Zbatimin e kompetencave të Agjencisë të ushtruara në përputhje me Rregulloren nr. 2002/12 me rastin e aplikimit të Agjencisë;

(d) Kërkesat për anulimin e transaksioneve të ndonjë ndërmarrjeje shoqërore që i është nënshtruar procedurës së likuidimit, siç është paraparë në nenin 9.4 të Rregullores nr. 2002/12 dhe

(g) Çështje të tjera që mund t'i caktohen me ligj.

4.2 Pavarësisht nga neni 4.1, Dhoma e veçantë mund t'ia bartë kërkesat e veçanta, kategoritë e pretendimeve ose pjesë të tyre cilëso gjykate që ka juridiksion për atë çështje sipas ligjit në fuqi. Asnjë gjykatë nuk mund të ushtrorë juridiksion për ndonjë pretendim që përfshin lëndën e përshkruar në nenin 4.1, përveç nëse një pretendim i tillë është paraqitur në pajtim me këtë nen.

4.3 Vendimi i gjykatës të cilës i është përcjellë lënda nga Dhoma e veçantë në pajtim me nenin 4.2 mund të apelohe vetëm në Gjykatën e veçantë dhe përjashtim bën vetëm nëse Gjykata e veçantë vendos ndryshe në pajtim me rregulloren e punës që do të nxirret konform nenit 7.

4.4 Asgjë në këtë nen nuk i paragjykon të drejtat e kërkuesëve të pagesave për të kërkuar shlyerjen e detyrimeve jashtë Dhomës së veçantë, të cilat nuk përfshijnë lëndën e përshkruar në nenin 4.1.

4.5 Pas paraqitjes së kërkesës nga Agjencia, në çdo kohë pas fillimit të administrimit të një ndërmarrjeje ose korporate, Dhoma e veçantë mund të tërheqë çdo padi që mbetet e pazgjdhur në ndonjë gjykatë në Kosovë, palë e së cilës është ajo ndërmarrje apo korporatë.

### Neni 5

#### Paraqitësit e kërkesave dhe të paditurit

Kërkuesit e pagesave në seancat para Dhomës së veçantë do të kufizohen vetëm në:

(a) Personat të cilët kërkojnë pronësi ose të drejta të tjera pronësore, huadhënësit dhe personat e tjerë të cilët kërkojnë interes të drejtpërdrejtë në lëndën e atij pretenmdimi;

(b) Agjencinë;

(c) Ndërmarrjet apo korporatat që janë nën autoritetin administrativ të Agjencisë dhe

(d) Personat e tjerë të cilët Dhoma e veçantë i konsideron plotësisht të nevojshëm për të marrë vendime për lëndën të cilën ajo e ka;

5.2 Të akuzuarit në proceset gjyqësore para Dhomës së veçantë do të kufizohen në:

(a) Agjencinë dhe në interes të saj lidhur me ndonjë pretendim të përshkruar në nenet 4.1(a) dhe (b);

(b) Një ndërmarrje a korporatë që ka qenë përpara ose që aktualisht është nën kontrollin administrativ të Agjencisë lidhur me ndonjë kërkesë të përshkruar në nenet 4.1(c) dhe (d);

(c) Personat ndaj të cilëve Agjencia ka ndonjë pretendim të përshkruar në nenet 4.1(e) dhe (f) dhe

(d) Personat e tjerë për të cilët Dhoma e veçantë i konsideron të nevojshëm për të marrë vendim të plotë dhe përfundimtar për lëndën që ajo e ka.

#### Neni 6

##### Afati i parqitjes së kërkesave për kundërshtimin e vendimeve apo veprimeve të Agjencisë

6.1 Kërkuesi i pagesës mund të bëjë kërkesë për kundërshtimin e një vendimi ose një veprimi të Agjencisë brenda nëntë (9) ditësh dhe më së voni nga: (a) data kur një kërkues i tillë ka ditur ose pas përpjekjeve të arsyeshme është dashur të dijë për vendimin a veprimin e Agjencisë dhe (b) data kur Dhoma e veçantë njofton publikisht se është në gjendje t'i pranojë kërkesat.

6.2 Dispozitat e parashtruara në nenin 6.1 i nënshtrohen njoftimit paraprak të Agjencisë nga ana e kërkuesit të pagesës konform nenit 30.2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2002/12.

6.3 Personi i paditur nga Agjencia, ndërmarrja apo korporata mund të bëjnë kundër-kërkesë ndaj Agjencisë, ndërmarrjes ose korporatës brenda afatit kohor të përcaktuar me ligjin në fuqi. Neni 30.2 i Rregullores nr. 2002/12 nuk vlen për një kundërkërkesë të tillë.

#### Neni 7

##### Rregullorja e punës e Dhomës së veçantë

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm nxjerr rregulla për udhëheqjen e procedurës gjyqësore nga Dhoma e veçantë me anë të një urdhërese administrative. Rregullat e tilla i ofrojnë palës një mundësi kuptimplote për të zgjidhur kërkesën e tij në mënyrë të paanshme dhe transparente brenda një afati të arsyeshëm kohor në përputhje me normat e përcaktuara sipas Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe duke i respektuar standardet ndërkombëtare në tërësi.

#### Neni 8

##### Sigurimi i provave dhe zhvillimi i senacave

8.1 Dhoma e veçantë mund t'i urdhërojë çdo personi në Kosovë që të paraqesë dokumente, të dëshmojë ose të ofrojë të dhëna të nevojshme përkatëse për gjykimin e një lënde në pajtim me rregulloren e punës që do të shpallet sipas nenit 7.

8.2 Dhoma e veçantë mund t'ia bartë kompetencat për mbledhjen e të dhënave ose zhvillimin e gjykimit një paneli të përbërë prej jo më pak se 2 anëtarë të saj, njëri prej të cilëve duhet të jetë gjykatës ndërkombëtar. Në çështjet kur shumica e kontestuar nuk i kalon dhjetë mijë euro (10.000 €), Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm mund t'ia bartë kompetencat një gjykatësi të vetëm. Provat e marra përpara kolegjit ose gjykatësit të vetëm sipas këtij paragrafi konsiderohen se janë paraqitur përpara Dhomës së veçantë.

### Neni 9

#### Vendimet e Dhomës së veçantë

9.1 Dhoma e Veçantë i lëshon vendimet brenda dy muaj ditësh pas përfundimit të procesit gjyqësor. Shqyrtimet e Dhomës së Veçantë janë private.

9.2 Vendimet e Dhomës së Veçantë për të vendosur për një kërkesë sipas nenit 4.1, për zgjidhjen e një ankese në përputhje me nenin 4.3 ose për marrjen e një vendimi konform nenit 4.5 kërkojnë votën përkrasë të së pakut tre (3) gjykatësve.

9.3 Vendimet sipas nenit 9.2 bëhen me shkrim dhe duhet:

- (a) Të pëmbledhin rrjedhën faktike dhe procedurale të procesit gjyqësor;
- (b) Të paraqesin konkluzionet faktike dhe arsyet ligjore për vendimin e tyre;
- (c) Të theksojnë bazën faktike dhe ligjore të kompensimit, nëse ka, për të cilin pala aktuale ka të drejtë në pajtim me dispozitat e nenit 10.

9.4 Dhoma e veçantë mund të lëshojë një vendim konform nenit 9.2 pa zhvillimin e shqyrtimit gjyqësor me qëllim të marrjes së provave dhe dëshmive:

- (a) Nëse kërkuesi i pagesës ka dorëzuar një kërkesë në të cilën nuk mund të jepet kurrfarë këshille e rregullt juridike si çështje e së drejtës materiale, duke i pranuar si të vërteta pohimet në kërkesën e kërkuesit të pagesës;
- (b) Nëse pasi palëve t'u jetë siguruar kohë e mjaftueshme për të paraqitur dëshmi të dokumentuara Dhoma e veçantë vendos se nuk ka mbetur asnjë kontest i vërtetë i fakteve materiale të nevojshëm për ta zgjidhur lëndën e mbetur.

9.5 Vendimi, konform nenit 9.2, duhet t'u komunikohet palëve brenda 30 ditëve.

9.6 Konform nenit 9.2 vendimet duhet t'i vëhen në dispozicion publikut.

9.7 Vendimi i marrë lidhur me një kërkesë sipas nenit 4 ose zgjidhja e ankesës konform nenit 4.3 është përfundimtar dhe i detyrueshëm për palët në fjalë dhe duhet të ekzekutohet nga organet adekuate në pajtim me ligjin në fuqi.

Neni 10  
Mjetet juridike

10.1 Kometencat e Dhomës së veçantë për të dhuruar ndihma i nënshtrohen kufizimeve të përcaktuara në këtë nen.

10.2 Vendimet përfundimtare kundër një ndërmarrjeje a korporate ekezkutohen vetëm në rastet kur prona është në pronësi të ndërmarrjes ose të korporatës së caktuar, duke përfshirë çfarëdo prone të asaj ndërmarrjeje a korporate e cila mbahet në mirëbesim nga Agjencia.

10.3 Vendimet përfundimtare me të cilat njihet një e drejtë, titulli ose interesi për ndonjë pasuri të veçantë që është në pronësi, në posedim ose në kontrollin e një ndërmarrjeje a korporate ekezkutohen kundër kësaj pasurie vetëm nëse ndërmarrja apo korporata e ka mbajtur të drejtën, titullin ose interesin në atë pasuri që nga data kur është lëshuar vendimi për dhurimin e asaj ndihme. Kur një e drejtë, titulli ose interesi i tillë është bartur në përputhje me vendimin e Agjencisë konform neneve 8 dhe 9 të Rregullores nr. 2002/12, pala gjyqituese e gëzon të drejtën për të marrë një kompenzim në të holla të barazvlefshëm me vlerën e asaj pasurie, e cila do të llogaritet në përputhje me rregulloren e punës së Dhomës së veçantë. Vendimi gjyqësor i cili lejon një kompenzim të tillë gëzon status prioritar ndaj kërkesave të pasiguruara të ndërmarrjes a korporatës së tillë.

10.4 Vendimet ndaj Agjencisë si të tilla i nënshtrohen dispozitave të nenit 18 të Rregullores nr. 2002/12.

10.5 Asnjë palë nuk ka të drejtë në këshillën juridike e cila kërkon anulimin e një transaksioni ose shfuqizimin e një kontrate të lidhur nga Agjencia në pajtim me kompetencat e saj sipas Rregullores së UNMIK-ut nr. 2002/12.

10.6 Dhoma e veçantë mund të jepë këshilla juridike të përkohshme në pajtim me rregulloren e punës që do të shpallet në përputhje me nenin 7.

Neni 11  
Shpenzimet

Dhoma e veçantë vendos lidhur për shpenzimet e proceseve gjyqësore, duke përfshirë pagesat e arsyeshme dhe kompenzimet e përfaqësuesit gjyqësor, që bëhen lidhur me ndjekjen e kërkesës në pajtim me rregulloren e punës e cila do të shpallet në përputhje me nenin 7.

Neni 12  
Ligji në fuqi

Kjo Rregullore shfuqizon çdo dispozitë tjetër të ligjit në fuqi që është në kundërshtim me të.

Neni 13  
Zbatimi

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm mund të nxjerrë urdhëresa administrative për zbatimin e kësaj Rregulloreje.

Neni 14  
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi më 13 qershor 2002.

(nënshkuar)  
Michael Steiner  
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm